

C.A.U.S.E. – Përdorimi i Pronave të Konfiskuara për Sipërmarrje Sociale është iniciativa e parë e kësaj natyre e zbatuar në Shqipëri dhe në rajonin e Ballkanit Perëndimor, që synon të krijojë një model të ri-përdorimit të qendrueshëm të aseteve të konfiskuara nga krimi i organizuar, nga organizatat e shoqërisë civile. C.A.U.S.E. zbatohet nga Partnerët Shqipëri, në partneritet me Project Ahead dhe Comitato Don Peppi Diana, dhe në bashkëpunim me Agjencinë e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara. Projekti financohet nga Bashkimi Evropian.



Buxheti total: 150,000 Euro

Kontributi i BE: 142,500 Euro (95%)

Periudha e zbatimit: 16 janar 2018 – 31 korrik 2019

Organizata zbatuese: Enti Kombëtar i Josefinëve të Murialdos
ENGIM në partneritet me Qendrën Sociale Murialdo

KeBuono Pasticeria sociale

KeBuono është një pasticëri sociale që zhvillon veprimtarinë e saj në një pronë të konfiskuar nga krimi i organizuar në Fier. Ajo ofron një shumëllojshmëri produktesh si dhe një seri aktivitesh integruese me fëmijë dhe prindër, adoleshentë, studentë, gra dhe vajza duke synuar ndërtimin në komunitet të një kulture të ligjshmërisë dhe kundër dhunës. Trajtime të formimit dhe aftësimi profesional u ofrohen të rinjve që janë ish të dënuar ose familjeve të të burgosurve aktualë që përballen me kushte të vështira jetese.

Duke kombinuar elemente të ndryshëm si: adresimi i konfliktit shoqëror për shkak të krimit të organizuar, punësimi i njerëzve në nevojë dhe promovimi i vlerave dhe të drejtave brenda komunitetit, KeBuono! kontribuon në kapërcimin e dyshimeve mbi ripërdorimin e pronave të konfiskuara nga krimi i organizuar në qytetin e Fierit.

75% e personelit janë të rinj, gra dhe vajza në rrezik apo viktime të aktivitetit kriminal dhe dhunës në familje në qytetin e Fierit.



Rezultate gjatë vitit të parë të zbatimit

- ✓ **4 gra dhe vajza** të rrezikuara apo viktime të krimit, të punësuar;
- ✓ **16 të rinj** të kualifikuar përmes trajnimeve profesionale nga të cilët **7** të rinj të punësuar;
- ✓ Bashkëpunim me **9 shkolla dhe qendra** në Fier duke mundësuar përfshirjen e më shumë se **700 fëmijëve** në aktivitete integruese dhe informimin e mbi **1,000 të rinjve** për çështje të ndryshme sociale me qëllim ndërtimin e një kulture të ligjshmërisë dhe kundër dhunës;
- ✓ Produktet më të shitura:
Croissant (970)
Akullore (750)
Kek (430)
Tortë Ditëlindje (60)
- ✓ **4 fushata ndërgjegjëse** të organizuara për të promovuar kulturën Rome, parandalimin e abuzimit me drogën dhe alkoolin, integrimin në shoqëri të personave me nevoja të veçanta dhe ndërgjegjësimin mbi dhunën me bazë gjinore.

